



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 496  
Datë: 12/4/2021

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 31, paragrafin 1 të Rregullores nr. 1/131, dt. 1.6.2015, të punës së Senatit të UP-së dhe vendimit nr. 4/12, datë 29.12.2020 të Senatit, në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2021, miratoj këtë:

**REKOMANDIM-UDHËZUES**

***Për mënyrën e realizimit të provimit pranues të përsëritur për kandidatët që kanë aplikuar në studimet e doktoratës nga Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Mjekësisë për vitin akademik 2020/21***


1. Provimi pranues do të organizohet nga njësitë akademike përkatëse me datë 22.04.2021 duke filluar nga ora 15.00.
2. Provimit pranues kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët të cilët kanë hyrë në provim me datën 23.11.2020 sipas konkursit nr. 2/262 të dt 23.10.2020.
3. Përgjashtimisht kufizimit si në paragrafin 2, provimit mund t'i nënshtrohen edhe kandidatët të cilët bazuar në njoftimin përkatës nga Fakulteti është dashur të njoftohen personalisht me shkrim për kohën e mbajtjes së provimit, por që nuk janë njoftuar në atë mënyrë.
4. Kandidatëve t' u pranohen 20 pikë nëse dëshmojnë që janë njohës të gjuhës së huaj nëpërmjet certifikatave përkatëse dhe atë si vijon:
  - a) Për gjuhën angleze: TOEFL dhe IELTS;
  - b) Për gjuhën gjermane: Goethe Institut (Goethe-Zertifikat B2, C1, C2); ÖSD – Österreiches Sprachdiplom (ÖSD-Zertifikat B2, C1, C2); TestDaF; DSH (Deutsche Sprachprüfung fuer den Hochschulzugang); DSD II (Deutsches Sprachdiplom der Kultusministerkonferenz);
  - c) Për gjuhën frënge: TCF; DELF B2 (Diplome d'études en langue française) dhe DALF C1 (Diplome approfondi de langue française).
  - d) Kandidatët të cilët nuk kanë dëshmi të certifikatës si në pikat a), b) dhe c), duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga gjuha angleze.
5. Kandidatët të cilët i takojnë kategorisë si në paragrafin 2 duhet të informohen nga shërbimi i administratës së fakultetit nëpërmjet emalit, për kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit pranues, brenda dy (2) ditëve pas miratimit të këtij udhëzuesi.
6. Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Mjekësisë të formojnë komisione të reja për organizimin e provimit pranues, në përbërje të të cilave nuk përjashtohet mundësia e përfshirjes së përfaqësuesit ndërkombëtar të fushës përkatëse.
  - 1.1. Komisioni për organizimin e provimit pranues duhet të përbëhet nga pesë (5) anëtarë.



- 1.2. Njësia akademike duhet të formoj nën komision të veçantë për hartimin e pyetjeve dhe përgjigjeve të provimit pranues me mundësi të përfshirjes së ekspertëve të jashtëm. Emërimi i anëtarëve të komisionit për organizimin e provimit pranues, nën komisionit për përgatitjen e provimit pranues dhe hartimi i pyetjeve duhet të bëhet në ditën kur edhe organizohet testi i provimit pranues. Testi i provimit pranues duhet të hartohet sipas standardeve më të larta akademike. Çelësi i përgjigjeve të sakta duhet të dorëzohet te komisioni për organizimin e provimit pranues pas përfundimit të provimit.
- 1.3. Anëtarët e nën komisionit për hartimin e pyetjeve dhe përgjigjeve duhet të vendosen në karantine gjatë fazës së përpilimit të pyetjeve dhe përgjigjeve. Të njëjtit duhet të qëndrojnë në karantinë deri në përfundim të provimit pranues.
- 1.4. Njësia akademike duhet të formoj ekipe të veçanta për shpërndarjen e testeve dhe mbikëqyrjen e provimit pranues.
- 1.5. Komisioni për organizimin e provimit pranues duhet të lejoj prezencën e monitoruesve të jashtëm si përfaqësues të institucioneve ose OJQ-ve, bazuar në kartelat përkatëse identifikuese.
- 1.6. Komisioni për organizimin e provimit pranues duhet të bëjë vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve preliminare.
- 1.7. Të gjithë anëtarët e komisioneve dhe nën komisioneve të përfshira në procesin e realizimit të provimit pranues janë të obliguar të nënshkruajnë paraprakisht deklaratën me të cilën dëshmojnë se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët të cilët kanë aplikuar.
7. Të respektohet pragu i kalueshmërisë nga provimi pranues (50%). Për pjesën e provimit nga gjuha angleze nuk kërkohet pragu i kalueshmërisë (50%), por këto pikë janë pjesë integrale e provimit pranues.
8. Komisioni i ankesave të fakulteteve përkatëse duhet t'i shqyrtoj me kujdes të gjitha ankesat dhe të nxjerrë përfundim të qartë dhe të arsyetuar nëse ato janë të bazuara ose të pa bazuara. Ankesat do të pranohen brenda 48 orëve pas publikimit të rezultateve preliminare, ndërsa kandidatët njoftohen në mënyrë individuale me përfundimin përkatës të komisionit të ankesave jo më vonë se 5 ditë pas publikimit të rezultateve preliminare.
9. Raportet nga Fakultetet me listat preliminare dhe raportet përkatëse të ankesave të shqyrtuara, dërgohen në Komisionin Qendror për Studime të Doktoratës i cili pas shqyrtimit të tyre bën rekomandimin përkatës për Senatin e UP-së. Senati i UP-së merr vendim përfundimtar lidhur me kandidatët të cilët do të pranohen në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/21. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të dhënat e kritereve të përzgjedhjes do të publikohen në ueb-faqen e fakultetit përkatës.

Udhëzuesit t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve të dy njësive akademike,
3. Të publikohet në ueb-faqe të UP-së,
4. Të publikohet në ueb-faqe të fakulteteve përkatëse



Prof. dr. Naser Sahiti, kryesues